



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:236545

Datë: 20.02.2025

Numri i dokumentit: 06877752

2024:236546

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me procesmbajtësen-praktikanten Djellza Hoxha në çështjen penale kundër të pandehurit N.A., për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1361/24 të dt.28.08.2024 , ka mbajtur shqyrtimit fillestar publik më datë 12.02.2025, në prani të prokurorit të shtetit Ardian Emini dhe të pandehurit, dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 20.02.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri N.A., nga i ati K., e ëma H., e gjinisë Q., i lindur më, në Ferizaj ku dhe tani jeton rruga "...", rrugica "...", ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal, i dënuar më parë për vepra penale të ndryshme, ndaj tij zhvillohen procedura tjetra penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 06.06.2024, rreth orës 20:58h, në rrugën “Gursel dhe Bajram Sylejmani” në Ferizaj, saktësisht tek marketi “Super Viva”, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me dashje ka vepruar, në atë mënyrë që ka hyrë në market dhe ka marrë - vjedh çamçakëzë “orbita” të cilat i kishte fshehur në “jakne” dhe kishte arrit t’i kaloj pengesat arkat e marketit dhe ishte larguar në drejtim të panjohur me çka verifikohet dhe identifikohet në bazë të kamerave të sigurisë së marketit, me ç’ rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 200 €.

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70 dhe 313 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neni 364, 452, 460 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurin e :

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 /dy/ muajve dhe me dënim në të holla në shumë prej 100 € /njëqind euro/. Dënimi i shqiptuar me burg do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa dënimin e shqiptuar me gjobë është e obliguar ta paguajnë në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, i njëjti dënim do të i shndërrohen në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’i llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20 Euro (njëzet euro), si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, që të dy shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E dëmtuara- Kompania “Super Viva”, në Ferizaj, rrugën “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr. 1361/24 të dt.28.08.2024 , ka ngarkuar të pandehurin për kryerje të veprës penale vjedhje nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe ka kërkuar që i pandehurit të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar për të pandehurin gjykohen nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës me datë 12.02.2025, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit dhe i pandehuri.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së. Dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i kanë kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se ti pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohen lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri deklaroi e pranoi fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saja, për veprën penale Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare, ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, tani po mundohem të punoj kohë pas kohe dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale, lus gjykatën që mundësisht të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë që është e mundur.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi, nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë pasi ky pranim i fajësisë është bërë në përputhje me dispozitat e nenit 242 të

KPPRK-së, pasi që i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri, po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe gjithashtu aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike. I propozoj gjykatës që pasi që të bëj pranimin e fajësisë të pandehurin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një dënim meritator sipas ligjit ashtu që konform nenit 69 dhe 70 të KPPRK-së, si rrethanë rënduese të merret shkalla e lartë e dashjes rrezikshmëria konkrete e veprës penale si dhe fakti se i pandehuri është recidivist i veprave penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit e kanë bërë vullnetarisht, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë, Raporti i Oficerit Policor i datës 06.06.2024: Deklarata e të pandehurit N.A., e dhënë në polici, e datës 15.08.2024: Deklarata e dëshmitares K. K., e dhënë në polici, me datë 06.06.2024: DVD- me video incizime, si dhe shkresa tjera të lëndës.

Meqenëse të pandehurit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK), ashtu siç është theksuar edhe në dispozitivat e këtij aktgjykimi, në të cilat është përshkruar datat, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale

për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtorë dhe iu shqiptua dënimet siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethana lehtësuese që në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë, pendimin dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë kësi lloj vepra penale apo të ngjashme, ndërsa në rastin konkret si rrethanë rënduese gjeti faktin se i njëjti ka qenë dënuar me aktgjykime të formës së prerë për vepra penale me aktgjykimet të plotfuqishme PKR. nr.97/2018, të datës 18.03.2019, 2023:2055380 të datës 10.01.2024, 2023:224855 të datës 16.07.2024, 2024:031104 të datës 05.09.2024, 2024:182037 të datës 14.11.2024, 2024:182881 të datës 14.11.2024, 2024:136912 të datës 18.11.2024, etj, si dhe vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë dhe të autorit të tij, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është marruar në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushall është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2024:236546, i datës 20.02.2025

Praktikante:
Djellza Hoxha

Gjyqtari i vetëm gjykues
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.